



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2023:209215

Datë: 01.10.2024

Numri i dokumentit: 06234597

C.nr.717/2019

PROCESVERBAL I SEANCËS PËRGATITORE

I përpiluar më datë 01.10.2024, në GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI - Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil në çështjen juridike të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit - Prishtinë të cilën sipas autorizimit e përfaqëson L.M kundër të paditurit V.M. , me objekt kontesti rimbursim dëmi.

Prezent:

Gjyqtari:
Leotrim Gashi

Për paditësen
L.M. sipas autorizimit

Zyrtare ligjore
Liridona Bajrami

Për të paditurin:
V.M.

Pyeten palët se a kanë vërejtje në përbërjen e gjykatës:

Pa vërejtje nga palët.

Seanca është publike

Filloj ne ora:10:20, për shkak të një seance paraprake [Click here to enter text.](#)

Gjyqtari i çështjes e hap shqyrtimin mbi këtë çështje, e publikon lëndën e shqyrtimit dhe konstaton se në këtë seancë prezent është përfaqësuesja e autorizuar i paditëses L.M dhe i padituri V.M. .

Andaj gjykata konstaton se ka kushte ligjore për mbajtjen e seancës, e si rrjedhojë merr:

A K T V E N D I M

Seanca e sotme mbahet dhe e njëjta është publike.

Gjykata i njofton palët prezente se duhet të mbajnë rendin dhe qetësinë në gjykatë dhe nuk duhet të flasin derisa gjykata të iu jap fjalën, për prishje të rendit dhe qetësisë në seancë gjyqësore, gjykata mund që duke u bazuar në nenin 289.2 të LPK-së, fillimisht do t'i qortojë palët dhe nëse kjo rezulton të jetë e pasuksesshme mundet që ti largoj nga salla dhe t'iu shqiptojë gjobë deri në 500 euro.

Gjykata i njofton palët së në këtë seancë përgatitore duhet të parashtrajnë të gjitha faktet në të cilat mbështesin kërkesat e tyre si dhe të propozojnë të gjitha provat më të cilat pretendojnë të vërtetojnë faktet e tilla.

Gjykata i njofton palët se kontestin mund ta zgjidhin edhe në procedurën e ndërmjetësimit, në pajtim me nenin 411 të LPK – së si dhe me anë të pajtimit gjyqësor siç parashihet në nenin 412 të LPK – së.

Lidhur me mundësinë e zgjidhjes së këtij kontesti përmes procedurës së ndërmjetësimit apo pajtimit gjyqësor, përfaqësuesja e paditëses, deklaron:

Nëse pajtohet edhe pala e paditur, jemi të gatshëm që të arrijmë pajtim gjyqësor, heqim dorë nga kamata ligjore dhe shpenzimet e procedurës ndërsa për kërkesën kryesore varësisht nga situata ekonomike e të paditurit mund të ia mundësojmë që pagesën ta kryej me këste mujore.

Lidhur me mundësinë e zgjidhjes së këtij kontesti përmes procedurës së ndërmjetësimit apo pajtimit gjyqësor, i padituri deklaron:

Lidhur me padinë, pajtohem që të arrij marrëveshje sa i përket shumës së kërkuar nga paditësja duke kërkuar nga të njëjtit që të më mundësohet pagesa në tri këste mujore.

Përfaqësuesja e paditëses lidhur me këtë opion deklaron:

Pajtohem që të ia mundësojmë të paditurit pagesën në tri këste ashtu që në dy muajt e parë të paguajë shumën prej 100 euro ndërsa në muajin e tretë shumën prej 151 euro.

Palët ndërgjyqëse deklarojnë se kanë arritur pajtim gjyqësor dhe i propozojnë gjykatës që ta aprovojë këtë:

PAJTIM GJYQËSOR

- I. DETYROHET i padituri V.M. , që në emër të shkaktimit të dëmit, në aksidentin e datës 17.07.2017, të ia rimbursojë paditëses shumën prej 351.00 euro dhe atë në tre këste mujore, ashtu që në dy muajt e parë të paguajë shumën prej 100.00 euro në muaj ndërsa në muajin e tretë shumën prej 151.00 euro. Muaji i parë i pagesës duhet të jetë muaji nëntor 2024 ndërsa muaji i fundit janar 2025. Pagesa për secilin muaj duhet të bëhet duke filluar nga data 01 deri 05 të çdo muaji (kësti) e cila shumë duhet të paguhet në xhironlogarinë e paditëses me numër ..., në Bankën Private të Biznesit (BPB).
- II. Paditësja heq dorë nga shpenzimet e procedurës dhe kamata ligjore.

Gjykata në bazë të nenit 411 dhe 412 të LPK –së, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pajtimi gjyqësor, i lartpropozuar nga ana e palëve ndërgjyqëse.
- II. Ky pajtim paraqet titull ekzekutiv dhe mund të goditet vetëm me padi.

Procesverbali pasi u dëgjua me zë i njëjti edhe u nënshkrua pa vërejtje.

Përfundoi në ora: 10:30 minuta.

Përfaqësuesja e paditëses

Zyrtarja ligjore

I padituri

Gjyqtari

V ë r t e t o j n ë